



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 98, Datë 09.04.2026

MBI

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2026 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.04.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1043/1 prot., datë 07.04.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Mars 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatohet se:

I -Aspektet Ligjore dhe Procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 2457 prot., datë 01.04.2026, protokolluar në ERE me nr. 1043 prot., datë 01.04.2026, ka depozituar kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin mars 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar.

II – Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Mars 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin Mars 2026, shoqëria FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve ditore/mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

2. Përlllogaritja e Çmimit Mesatar të Ponderuar të Blerjes (ÇBET)

Referuar të dhënave të paraqitura, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBET) i përlllogaritur nga shoqëria për muajin mars 2026 është **10.23 lekë/kWh**. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rilllogaritja e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është **10.23 lekë/kWh**, sikurse pasqyruar edhe në përlllogaritjet e përcjella nga vetë shoqëria.

3. Komponentët sipas Metodologjisë (Neni 8, vendimi nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBET)** për muajin Mars 2026: **10.23 lekë/kWh**;
 - **Tarifa e shërbimit të transmetimit** të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025 – 31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kWh**;
 - **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes** në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”: **1.55 lekë/kWh**;
 - **Kostot administrative: 1.06 lekë/kWh**;
 - **Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (Lekë/Euro)**, për çdo datë respektive të harkut kohor **27.02.2026 – 30.03.2026**.
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Mars 2026, përlllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin mars 2026</i>		
	Njësia	Çmimi
CBET	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh 10.23
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh 0.31
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh 1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të njetit të transmetimit	Lekë/kWh 0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të njetit të shpërndarjes	Lekë/kWh 1.55
Çmimi i energjisë = CBET + Pr * CBET + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh 14.00

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton *14.00 Lekë/kWh për muajin Mars 2026*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2026 prej 14.00 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletore

KRYETARI

Petrit AHMETI